



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva, Trgovine i Inovacije
Ministry of Industry, Entrepreneurship, Trade, and Innovation

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë - KIESA

INSTRUMENTI FINANCIAR PËR MBËSHTETJE TË INDUSTRISË KREATIVE – FAZA 2

Udhëzues për aplikim: Thirrje publike për përkrahje financiare të ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM), në sektorin e Industrive Kreative (IK).

Autoriteti kontraktues dhe zbatues: Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI), respektivisht Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA).

1. Hyrje

MINTI/KIESA, në bashkëpunim me UNDP, më datë 08 maj 2025, kanë nënshkruar marrëveshjen për themelimin e Instrumentit Financiar për Mbështetje (IFM) të NMVM-ve të industrisë kreative. Qëllimi i këtij instrumenti është nxitja e inovacionit, zhvillimit, rritjes dhe rritjes së vizibilitetit të industrisë kreative në Kosovë. Vlera totale e IFM-së, sipas marrëveshjes, është 1.45 milionë euro, nga të cilat 950,000.00 euro janë financuar nga Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut, ndërsa 500,000.00 euro janë financuar nga MINTI/KIESA.

2. Qëllimi i thirrjes

Industria kreative konsiderohet një sektor me potencial të lartë për nxitjen e inovacionit, krijimin e vendeve të reja të punës, gjenerimin e të ardhurave dhe kontributin në rritjen e eksportit. Për këtë arsye, IFM është dizajnuar për të përkrahur ndërmarrjet e industrisë kreative që paraqesin propozime inovative dhe që synojnë të rrisin produktivitetin, qëndrueshmërinë, cilësinë dhe dukshmërinë e produkteve apo shërbimeve të tyre, me fokus në zgjerimin e pjesëmarrjes në treg. IFM-ja ka për synim të fuqizojë industrinë kreative në Kosovë, duke nxitur zhvillimin e saj dhe kontributin social dhe ekonomik të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirëse.

3. Sektorët e pranueshëm

Fusha e veprimtarisë primare apo sekondare e ndërmarrjeve duhet të jetë në përputhje me nën-sektorët e industrisë kreative, sipas klasifikimit të kodeve NACE, si në vijim:

Tabela 1: Sektorët kryesorë të industrive kreative sipas klasifikimeve ndërkombëtare

1393	Prodhimi i qilimave, sixhadeve dhe tepihëve
1399	Prodhimi i tekstileve të tjera p.k.t
1413	Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme
1419	Prodhimi i veshjeve të tjera dhe atyre plotësuese (dorëzave, kapelave, shalleve etj.)

1512	Prodhimi i valixheve, çantave dhe gjëseneve të ngjashme si takëmeve të kuajve dhe parzmoreve
1629	Prodhimi i produkteve të tjera nga druri; prodhimi i artikujve nga tapa, kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurëse
2341	Prodhimi i produkteve të qeramikës për përdorim shtëpiak dhe zbukurues
3212	Prodhimi i stolive të çmuara dhe artikujve të ngjashëm me to
3213	Prodhimi i stolive imituese dhe artikujve të tjerë të ngjashëm
3220	Prodhimi i instrumenteve muzikore
5811	Publikimi i librave
5911	Aktivitetet e prodhimit të filmave, videove dhe programeve televizive
5912	Aktivitetet e post-produksionit të filmave, videove dhe programeve televizive
5920	Incizimi i zërit dhe aktivitetet e publikimit të muzikës
7111	Aktivitetet e arkitekturës
7410	Aktivitetet e specializuara të dizajnit
9001	Shfaqjet artistike
9002	Aktivitetet mbështetëse për shfaqje artistike
9003	Krijimtaria artistike
9004	Funksionimi i objekteve të artit

Shënim: Të kodet 5911 dhe 5912 përjashtohen programet televizive, ndërsa kodi 5811 përfshinë botimin e veprave të reja të krijuesve vendorë, si dhe përkthimin e veprave të krijuesve vendor në gjuhë të huaja.

4. Kategoritë e përkrahura dhe kushtet financiare

Vlera totale e IFM-së për fazën e dytë është 450,000.00 €, e cila planifikohet të shpërndahet përmes tre kategorive të ndërmarrjeve, si më poshtë:

Tabela 2: Përkrahja sipas kategorive

Kategoria	Numri i punonjësve	Shuma maksimale e financimit	Bashkëfinancimi minimal	Buxheti total për kategori
Kategoria 1: Mikro	deri 9	20,000.00 €	10%	200,000.00 €
Kategoria 2: Të Vogla	10 - 49	35,000.00 €	15%	150,000.00 €
Kategoria 3: Të Mesme	50 - 249	45,000.00 €	20%	100,000.00 €

5. Rezultatet e pritura

Projektet e përzgjedhura parashikohet të arrijnë rezultate konkrete deri në fund të periudhës së zbatimit të projektit, në këto drejtime:

- Ngritja e kapaciteteve prodhuese / krijuese apo e produktivitetit.
- Krijimi, zhvillimi ose përditësimi i produkteve/shërbimeve përmes koncepteve inovative.
- Përmirësimi i markës ose prezencës digjitale të ndërmarrjes.
- Zgjerimi i pjesëmarrjes në tregun vendor, rajonal apo ndërkombëtar.
- Rritja e bashkëpunimit dhe ndërtimi i partneriteteve të reja strategjike.

6. Dokumentet e kërkuara për aplikim sipas Udhëzimit Administrativ 01/2018

1. Certifikata e regjistrimit të ndërmarrjes me të gjitha informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.
2. Certifikata e numrit fiskal (nuk aplikohet për ndërmarrjet të cilat numrin e regjistrimit të ndërmarrjes dhe numrin fiskal e kanë në një certifikatë).

3. Vërtetimi tatimor me të cilin vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime tjera tatimore ose është në marrëveshje për shlyerjen e borxhit me ATK.
4. Lista e punëtorëve për vitin 2025 dhe 2026, të lëshuar nga ATK, me emrin e ndërmarrjes e në harmoni me NUI (mund të shkarkohet online nga ueb faqja e ATK-së). Në bazë të listës, do të kategorizohen dhe vlerësohen NMVM-të, si dhe do të vlerësohen piket e punësimit të gjinisë femërore. Për ndërmarrjet e regjistruara gjatë vitit 2026 duhet të sjellin listën e punëtorëve që nga regjistrimi.
5. Kopje të letërnjoftimit të personit në emër të së cilit/ës është i/e regjistruar ndërmarrja.
6. Dëshmi nga aplikuesi se nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësor të lëshuar nga Gjykata Themelore - kërkohet kopja origjinale jo më e vjetër se 30 ditë. Dokumenti nxirret në Gjykatën Komerciale të Kosovës.
7. Dëshmia e xhironlogarisë aktive në emër të ndërmarrjes aplikuese, në njërin prej bankave të licencuara nga Banka Qendrore e Kosovës.
8. Gjendja e xhironlogarisë bankare në emër të ndërmarrjes aplikuese për vitin e fundit (2025). Për aplikuesin e sapo themeluar kjo nuk është e aplikueshme.
9. Oferta e realizimit të projektit, të dëshmohet vetëm për shpenzimet që domosdo duhet të blihen të një subjekt tjetër afarist.
10. Të mos ketë pranuar mjete nga burime të tjera të financimit për të njëjtat aktivitete (e dëshmuar me deklaratë nën betim, e cila duhet shkarkuar nga ueb faqja e KIESA-së, të plotësohet me të dhënat e ndërmarrjes dhe të dërgohet në email adresën: aplikimi.ikreative@rks-gov.net).
11. Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit nga MINTI për dy vitet e fundit, (e dëshmuar me deklaratë nën betim, e cila duhet shkarkuar nga ueb faqja e KIESA-së, të plotësohet me të dhënat e ndërmarrjes dhe të dërgohet në email adresën: aplikimi.ikreative@rks-gov.net).
12. Për ndërmarrjet e regjistruara para vitit 2024, duhet të sjellin qarkullimin për vitin 2024 dhe 2025 i dëshmuar me dokument të lëshuar nga ATK. Për ndërmarrjet e regjistruara gjatë viteve 2024 dhe 2025 duhet të sjellin qarkullimin total që nga regjistrimi. Ndërsa, për ndërmarrjet e regjistruara gjatë vitit 2026 duhet të sjellin qarkullimin total që nga regjistrimi.
13. Projekt propozimi si model mund të shkarkohet nga ueb faqja e KIESA-së, të plotësohet dhe i njëjti të i dërgohet përmes email adresës: aplikimi.ikreative@rks-gov.net, dhe të jetë në harmoni me ofertën për realizim të projektit, përfshirë pikat si në vijim dhe në rast të përfitimit, projekt propozimi do të reflektohet në tërësi në marrëveshjen mes palëve:
 - Pasqyrë mbi veprimtarinë e biznesit tuaj dhe karakteristikat kryesore të produkteve apo shërbimeve që ofroni.
 - Qëllimin e projektit përfshirë konceptin inovativ;
 - Aktivitet dhe rezultatet e pritshme, përfshirë planin kohorë;
 - Koston dhe burimet financiare;
 - Strukturën organizative si dhe objektivat e ndërmarrjes;
 - Kapacitetet aktuale prodhuese dhe synimet e rritjes së prodhimit krijues dhe eksportit.
14. Një video me kohëzgjatje deri në 2 minuta që paraqet konceptin e projekt propozimit, duhet të behet përmes linkut, vetëm në njërin nga platformat si ne vijim: Youtube, Google Drive, Vimeo, One Drive ose Drop Box.

7. Informacione mbi shpenzimet e pranueshme dhe të papranueshme

- Shpenzimet e pranueshme përfshinë blerjen e pajisjeve dhe teknologjisë, materialeve dhe furnizime prodhimi, brendim dhe marketing, përmbajtje krijuese, materiale të specializuara, pjesëmarrje në panaire/ekspozita/festivale/rrjete, si dhe eksport.
- Materialet dhe furnizime prodhimi nuk duhet të kalojnë 30% të buxhetit të kërkuar, si dhe çfarëdo aktiviteti promovues nuk duhet të kaloj 30% të buxhetit të kërkuar.
- Të gjitha shpenzimet duhet të planifikohen me kujdes për kohëzgjatjen e projektit, të justifikohen qartë në aplikim dhe të mbështeten nga dokumentacioni i vlefshëm, siç janë kuotat, ofertat ose kontratat.
- Shpenzimet që lidhen me qira të hapësirës së punës, pagat e stafit administrativ, ose shpenzimet operative të zakonshme nuk konsiderohen si shpenzime të pranueshme për mbështetje në kuadër të IFM-së për sektorin krijues.
- Shpenzimet e kryera para nënshkrimit të marrëveshjes së grantit nuk janë të pranueshme për financim. Buxheti përfundimtar i miratuar do t'i nënshtrohet verifikimit nga Autoriteti Kontraktues.

8. Sqarime shtesë

- Aplikacioni dhe buxheti të shkarkohen nga ueb faqja e KIESA-së, në njërin nga gjuhët: shqipe, serbe apo angleze.
- NMVM-të e njëjta që kanë përfituar gjatë vitit 2024 dhe 2025 nga skemat KIESA-së, përfshirë edhe skemën e industrisë kreative nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga kjo thirrje.
- Aplikacionet do të diskualifikohen në mungesë të cilitdo dokument të kërkuar.
- Nuk pranohen ndryshimet në ARBK gjatë fazës së aplikimeve të thirrjes publike, si dhe për ndërmarrjet përfituese, pas shpalljes së listës preliminare deri te realizimi i pagesës.
- Bizneset kanë të drejtë të aplikojnë vetëm një herë, duke përdorur një adresë të vetme emaili. Çdo biznes që dërgon më shumë se një aplikim me email të ndryshëm do të diskualifikohet.
- Ndërmarrjet përfituese do të jenë të renditura sipas numrit të pikëve nga komisioni vlerësues. Varësisht nga limitet buxhetore, lista e ndërmarrjeve përfituese mund të parasheh listën rezerve.
- Lista e ndërmarrjeve të radhitura sipas pikave të fituara në bazë të aplikacionit të vlerësuar publikohet në ueb faqe të MINTI/KIESA.
- Nga kjo thirrje përjashtohen kompanitë konsulente që ofrojnë shërbime për ndërmarrjet aplikuese. Në rast të identifikimit të përfshirjes së tyre si përfaqësuese të ndërmarrjeve, aplikuesit do të diskualifikohen. Kjo, për arsye se i gjithë procesi është i thjeshtë dhe pa kosto financiare, duke filluar nga mënyra elektronike e aplikimit përmes emailit aplikimi.ikreative@rks-gov.net, e deri të vlerësimi, nënshkrimi i marrëveshjeve, disbursimi i mjeteve dhe monitorimi i tyre.
- Para nënshkrimit të marrëveshjes, ndërmarrjet përfituese obligohen të sjellin garancion nga kompanitë e sigurimit apo nga bankat, për vlerën totale të mbështetjes financiare.
- Në rast që ndërmarrja do të jetë përfituese, atëherë do të nënshkruhet marrëveshje dypalëshe (MINTI/KIESA dhe ndërmarrja), pjesë e secilës do të jenë edhe deklarimet që janë bërë me rastin e aplikimit.
- Pas nënshkrimit të marrëveshjes, ndërmarrjes përfituese do t'i transferohen 100% e vlerës së aprovuar.

- TVSH është shpenzim i pranueshëm për persona fizik dhe ndërmarrjet jo deklaruese të TVSH-së, ndërsa për ndërmarrjet që janë deklaruese të TVSH-së, ky është shpenzim i papranueshëm.
- Gjatë procesit të monitorimit, ndërmarrjet përfituese duhet të dëshmojnë shpenzimet me fatura, e mbështetur me transaksion bankar sipas aktiviteteve financiare të paraqitura në ofertë, derisa për aktivitetet që jo patjetër kërkohet ofertë të një subjekt tjetër afarist, atëherë vlejné të gjitha zotimet të pasqyruara nga aplikuesit në projekt-propozim dhe të njëjtat të dhëna do të jenë pjesë përbërëse e marrëveshjes.
- Ndryshimi i ofertës mund të bëhet vetëm me kërkesë të veçantë e cila parashtrohet në MINTI/KIESA, respektivisht në komisionin monitorues. Kërkesa duhet të mbështetet në arsye të qëndrueshme nga përfituesi dhe e njëjta mund të zbatohet vetëm pas miratimit të kërkesës, me ç'rast nuk ndryshon koncepti i projektit dhe shuma e mbështetjes nga MINTI/KIESA. Në rastet kur oferta ka çmim më të lart se ajo e prezantuar në projektin aplikues, ndryshimi i çmimit është obligim i përfituesit dhe në asnjë rast nuk ndryshon vlera e mbështetjes nga MINT/KIESA.
- Në rast se informatat e dhëna në këtë aplikacion vërtetohen që janë të pasakta, ndërmarrjes nuk do t'i realizohet pagesa dhe e njëjta do të mbajë përgjegjësi për të gjitha pasojat, sipas legjislacionit relevant në fuqi.
- Përparësi u jepet bizneseve me gra ndërmarrëse, start up bizneseve dhe ndërmarrjeve që kanë deklaruar aktivitet eksportues.
- Në rast që nuk plotësohet kuota në ndonjërin nga kategoritë, atëherë pjesa e mbetur e buxhetit mund të bartet në kategoritë e tjera. MINTI/KIESA rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion.

9. Tabela 3: Kriteret e vlerësimit

#		Pikët maksimale		
		Kategoria 1	Kategoria 2	Kategoria 3
1	Vlerësimi i projekt propozimit	50	50	50
2	Vlerësimi i idesë kreative/inovacionit	10	10	10
3	Vlerësimi i qarkullimit vjetor të ndërmarrjeve aplikuese, sipas nënpikës 12 të pikës 6 të këtij udhëzuesi	20	20	20
4	Përqindja e të punësuarve të gjinisë femërore, nga një (1) pikë për çdo 10% të të punësuarve të gjinisë femërore.	10	10	10
5	Ndikimi Social dhe Ekonomik: Numri i vendeve të reja të punës të parashikuara për t'u krijuar gjatë dhe pas përfundimit të projektit.	Nga pesë (5) pikë për çdo një (1) që do të punësoj	Nga 3.33 pikë për çdo një (1) që do të punësoj	Nga dy (2) pikë për çdo një (1) që do të punësoj
		10	10	10

10. Kohëzgjatja dhe zbatimi

Afati maksimal për realizimin e projektit është 6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. Bizneset janë të obliguara të raportojnë të paktën 30 ditë para skadimit të marrëveshjes.

11. Aplikimi

- Njoftimi për thirrje publike është i publikuar në ueb faqen zyrtare të MINTI-t dhe të KIESA-s:
 - <https://mint.rks-gov.net/>
 - <http://kiesa.rks-gov.net/>

- Aplikimi bëhet vetëm përmes email adresës: aplikimi.ikreative@rks-gov.net
- Afati për aplikim: nga data 20.04.2026 deri më 12.05.2026.
- Informatat shtesë mund të merren përmes email adresës: sme.kiesa@rks-gov.net

12. Ankesat

Pas publikimit të rezultateve preliminare, aplikuesit mund të adresojnë ankesa brenda afatit të paraparë me UA 01/2018, përmes email adresës: aplikimi.ikreative@rks-gov.net

Shënim:

- Nëse vërtetohet se informacionet e paraqitura në aplikacion janë të pasakta, përfituesit nuk do t'u bëhet pagesa dhe do të mbajnë përgjegjësi sipas legjislacionit në fuqi.
- Të gjitha zotimet lidhur me të dhënat e ofruara që do të përdorën tek kriteret e vlerësimit duhet të pasqyrohen nga aplikuesit në projekt-propozim dhe të njëjtat të dhëna do të jenë pjesë përbërëse e marrëveshjes.